




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA PROTIV KORRUPCIE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
Dep. 02
Nr. Prot. 01-288/15
Br. Prot. 03-02-2015
Data 03-02-2015
PRISHTINE

DATË/A:	02.02.2015
REFERENC-Ë:	AKK-D.P.K.
PËR/ZA/TO:	z. Behxhet Haliti – Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës
Cc:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni – Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion - Ofrimi i këshillimit profesional lidhur me Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik



I nderuari ztr. Haliti

Lidhur me kërkesën tuaj të drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit (DPK-03-02/201/14), ju njoftojmë se në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I.), Agjencia: *"bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe me regjistrimin rast për rast të interesave"*, (Neni 19, pika 1.5, e Ligjit Nr.04/L-051).

Prandaj bazuar në kërkesën tuaj drejtuar AKK-së, ku keni cituar se jeni ne vitin e fundit te mandatit si Drejtor i ATK-së, dhe planifikoni për te konkurruar, për anëtar të bordeve apo pozita tjera të cilat i përgjigjen kualifikimit dhe provojës tuaj profesionale, dhe dëshironi ta din se a paraqet konflikt interesi konkurrimi, në pozitat e lartcekura gjatë periudhës se ardhshme, si dhe ne rast te përzgjedhjes si duhet te veproj.

Në pajtim me mandatin që kemi dhe duke u bazuar në ligjet në fuqi, për pyetjet e caktuara që na jeni drejtuar, për të ju dhënë një përgjigje ju ofrojmë këtë :

OPINION

Ekziston kufizim për zyrtarin e lartë publik pas përfundimit të ushtrimit të funksionit Publik.

Situata e angazhimit të zyrtarit të lartë pas përfundimit të mandatit është e rregulluar me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe konkretisht nën 17 të këtij ligji ka paraparë se :

Zyrtari i lartë i cili përfundon ushtrimin e funksionit publik nuk ka të drejtë për një vit të punësohet ose të emërohet në pozitë udhëheqëse, apo të përfshihet në kontrollin e ndërmarrjeve publike apo private, nëse detyrat e tij gjatë periudhës dy vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me mbikëqyrjen apo kontrollin e afarizmit të atyre ndërmarrjeve.

Po ashtu ju njoftojmë se aplikimi apo konkurrimi i juaj për qfar do pozite nuk është e ndaluar apo kufizuar, mirë po gjithmonë duhet shikuar nën 17 i Ligjit Nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, që të vërtetoni se a ju kufizohet ushtrimi i funksionit pas përfundimit të mandatit sipas kësaj dispozite, pra a keni qenë të lidhur drejtpërdrejtë me mbikëqyrjen apo kontrollin e afarizmit të atyre ndërmarrjeve.

Prandaj duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lartë, ju rekomandojmë që të veproni konform këtij Opinioni të bazuar në Ligjin Nr.04/L-051, për të parandaluar dhe shmangur çdo situatë që mund të sjellë në gjendje të konfliktit të interesit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Me respekt,